

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Auditim
zgjidhja

P6

Data 05/12/2020

Detyra 1

Ju jeni menaxher i auditimit në firmën e auditimit AuditCon dhe jeni duke rishikuar dokumentimin e sistemit të blerjes së kompanisë klient Linda Shpka si përgatitje për auditimin e ndërmjetëm. Linda është prodhues i produkteve elektronike. Fabrikat e kompanisë gjinden në tërë vendin dhe konsumatorët janë kompani të mesme dhe të mëdha të shitjes me pakicë. Fundi i vitit të kompanisë është 31 dhjetor 2019.

Sistemi i blerjes

Pas pranimit të faturës nga zyra e kontabilitetit, fatura përputhet me fletë-pranimin përkatës, duke përdorur numrin e urdhërblërjes që është i shënuar në faturë. Nëse nuk ka numër të urdhërblërjes të shënuar në faturë, ky numër duhet të merret nga furnitori.

Numri i faturës shënohet në fletë-pranim dhe fatura po ashtu kontrollohet me urdhërblërjen origjinale për tu siguruar se çmimet dhe zbritjet janë të sakta sipas marrëveshjes. Nëpunësi I librit të blerjes i regjistron faturat në sistemin e blerjes në grupe (grumbuj). Në këtë rast përdoret një listë kontrolluese për secilin grup të faturave. Kjo listë përmban detajet e numrit të faturës dhe vlerën totale. Këto detaje kontrollohen me raportin e sistemit para se të dhënat të konfirmohen për tu procesuar në sistem.

Secila faturë vuloset me “e regjistruar” pasi që detajet e faturës janë futur në sistem. Menaxheri i librit të blerjes inspekton dosjet e faturave në bazë mujore për t’u siguruar se të gjitha faturat janë regjistruar në sistem.

Nga furnitorët kërkohet të dërgojnë ekstraktet (kartelat) mujore të cilat pastaj harmonizohen me llogaritë individuale të furnitorëve nga menaxheri i librit të blerjes. Libri i blerjes harmonizohet me llogarinë kontrolluese të blerjes në baza mujore dhe rishikohet nga kontabilisti i kompanisë.

Lista e pagesave dërgohet te kontabilisti i kompanisë nga menaxheri i librit të blerjes. Kontabilisti përputh detajet e secilës pagesë me faturën përkatëse dhe nënshkruan secilën faturë për të autorizuar pagesën dhe dëshmon se kontrolli është kryer. Lista e pagesave nënshkruhet nga kontabilisti pasi të gjitha faturat janë kontrolluar dhe kjo listë pastaj dërgohet te arkëtari i kompanisë për të kryer pagesat nga banka.

Nëse ndonjë pagesë individuale është më e lart se €25,000 ose totali i pagesave është më i lart se €250,000 kërkohet nënshkrimi i dytë. Këto pagesa po ashtu duhet të kontrollohen dhe nënshkruhen nga shefi i kontabilitetit ose drejtori financiar. Pagesat bëhen nga zyra e arkëtarit përmes transferit bankar njëherë në javë. Faturat vulosen me “e paguar” dhe kthehen te ekipi i librit të blerjes të cilët e regjistrojnë pagesën në kontabilitet dhe i arkivojnë faturat (ndaras nga faturat që nuk janë paguar ende).

Menaxheri i librit të blerjes kontrollon fletë-pranimet në baza mujore për të siguruar se faturat janë pranuar dhe paguar me kohë.

Kërkohet:

- a) Sa i përket kontrolleve të brendshme në sistemin e blerjes së Linda Shpk:
 - (i) Diskutoni gjashtë kontrolle efektive ekzistuese në sistemin e blerjes së Linda.
 - (ii) Përshkruani nga një test për secilin kontroll të diskutuar më sipër për të testuar efektivitetin e secilit kontroll. (12 pikë)
- b) Përshkruani procedurat thelbësore (pavarura) të cilat duhet të kryhen në fund të vitit për të konfirmuar vlerën e blerjeve që paraqitet në pasqyrën e të ardhurave të Linda. (6 pikë)
- c) Listoni katë shembuj të konfirmimeve të jashtme. (2 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

Sistemi i blerjes

(i) Kontrolllet efektive	(ii) Testet e kontrolleve
<p>Kontrollet mbi grupet e faturave përdoren mbi procesin e regjistrimit të të dhënave. Kjo mundëson identifikimin e gabimeve dhe korrigjimin e tyre me kohë.</p>	<p>Vëzhgoni procesin e regjistrimit të faturave për të siguruar se listat kontrolluese të faturave plotësohen dhe përputhen me raportin nga sistemi i gurpit të faturave. Me lejen e klientit tentoni të procesoni një mostër të faturave pa konfirmuar totalin e grupit. Sistemi nuk do të duhej të procesonte faturat pa konfirmimin e të dhënave.</p>
<p>Faturat vulojnë me “e regjistruar” dhe kontrollet shitesë sigurojnë se të gjitha faturat janë regjistruar. Kjo e siguron plotësinë e përpunimit të të dhënave dhe parandalon që faturat të procesohen dy herë, duke zvogëluar kështu rrezikun e mbivlerësimit të pagueshmeve.</p>	<p>Përzgjedh një mostër të faturave të regjistruara në sistem dhe inspektoni ato për të siguruar se janë shënuar si të “regjistruara”.</p>
<p>Kryhen harmonizime të të kartelave mujore të furnitorëve. Kjo mundëson që blerjet dhe pagesat e regjistruara gabimisht të identifikohen dhe korrigjohen me kohë.</p>	<p>Për një mostër të furnitorëve, inspekto kartelat e furnitorëve për dëshmi të harmonizimit.</p>
<p>Kryhen harmonizime të rregullta të llogarisë kontrolluese. Kjo siguron se kreditimi dhe pagesa e regjistruara në llogaritë individuale të furnitorëve janë regjistruar në pasqyra dhe e kundërta. Ndarja e detyrave monitoron performancën e kontrolleve dhe parandalon mashtrimin.</p>	<p>Inspektoni librin e blerjeve për dëshmi të performancës dhe rishikimit në baza mujore.</p>
<p>Kontabilisti i kompanisë kontrollon dhe autorizon pagesat individuale. Pagesat duhet të autorizohen nga një anëtar senior i departamentit të financave për të minimizuar rrezikun e mashtrimit.</p>	<p>Për një mostër të pagesave të kryera, inspekto listën e pagesave për të marrë dëshmi lidhur me rishikimin dhe autorizimin e kryer nga kontabilisti.</p>
<p>Pagesat individuale në vlerë më të lartë se €25,000 ose gjithsej pagesat më të larta se €25,000 kërkon autorizim të dytë. Kjo redukton rrezikun e mashtrimit ose gabimit për pagesat me vlerë të lartë.</p>	<p>Përzgjedh një mostër të faturave me vlerë më të lartë se €25,000 gjithsej pagesat më të larta se €25,000 dhe kontrollo dokumentimin e sistemit të blerjes për të siguruar se kontabilisti dhe drejtori financiar janë nënshkruar autozimet.</p>
<p>Pagesat bëhen nga zyra e arkëtarit dhe regjistrohen nga ekipi i librit të blerjes. Ndarja e detyrave parandalon mashtrimin dhe gabimin.</p>	<p>Vëzhgo sistemin e pagesave dhe regjistrimit për të siguruar se ka ndarje të mjaftueshme të detyrave.</p>

Faturat vulosen me “e paguar” dhe arkivohen ndaras nga faturat qe nuk janë paguar ende. Kjo parandalon që faturat të paguhen dy herë.	Inspekton dosjen e faturave të paguara dhe sigurohu se mbahen ndaras nga faturat e papaguara. Inspekto një mostër të faturave për dëshmi të vulës së pagesës.
Fletëpranimet kontrollohen në baza mujore. Siguron se furnitorët paguhen në baza mujore, e cila siguron se zbritjet në dizpozicion për pagesa të hershme edhe pranohen dhe ruhet marrëdhënia e mirë me furnitorët.	Rishiko dëshmi për rishikim mujor nga menaxheri i librit të blerjeve.

Procedurat e pavarura: blerjet

- Përzgjedh një mostër të fletëpranimet para fundit të vitit dhe ndjekni ato deri në përfshirje në pasqyrën e të ardhurave: verifikon **prerjen** e blerjeve.
- Rillogarit një mostër të kostove duek iu referuar fletëpranimeve dhe kontratave dhe listës së pagesave: verifikon **saktësinë** e blerjeve.
- Rishiko faturat pas datës për tu siguruar se ka/nuk ka zëra që duhet të shpenzohen: verifikon **plotësinë** e blerjeve.
- Rishiko pagesat pas datës, nëse kanë të bëjnë me vitin actual ndiqni ato dei në pasqyrën e të ardhurave: verifikon **plotësinë** e blerjeve.
- Rillogarit zbritjet dhe TVSH nga një mostër e faturaves: verifikon **saktësinë** e blerjeve.
- Përzgjedh një mostër të urdhërblerjeve dhe përputh me fletëpranimet dhe faturat e blerjes deri në përfshirje në pasqyrën e të ardhurave: verifikon **plotësinë** e blerjeve.
- Llogarit marzhën e fitimit bruto për vitin aktual dhe krahaso me vitin e kaluar. Heto ndonjë luhatje domethënëse: verifikon **saktësinë, plotësinë** dhe **ndodhjen** e blerjeve.
- Për një mostër të furnitorëve, përfto kartelat e tyre, harmonize me saldot nga libri i blerjeve dhe heto ndonjë zë që nuk përputhet: verifikon **ndodhjen** dhe **plotësinë** e blerjeve.

Katër shembuj të konfirmimeve të jashtme:

1. Konfirmimet e llogarive të arkëtueshme
2. Letra e avokatit
3. Konfirmimi bankar
4. Stoqet e mbajtura nga palët e treta

Detyra 2

Bungu ShA është kompani që operon tash e shumë vite si shitës me pakicë i mobiljeve në 500 dyqane në më shumë se 20 shtete. Edhe pse kompania është ende profitabile, ka pasur një rënie domethënëse në shitje në dy vitet e fundit, kryesisht për shkak të krizës ekonomike. Konkurrenca në sektorin e shitjes së mobiljeve është rritur kryesisht përmes ofrimit të zbritjeve ndaj konsumatorëve.

Përveç investimit prej €20 milion në rinovimin e dyqaneve, kompania po ashtu ka investuar edhe €1.5 milion në platformën online të shitjes. Këto investime janë financuar përmes kredisë bankare. Kjo i ka mundësuar kompanisë të jetë më konkurruese në treg duke ofruar zbritje në çmimin e shitjes për një numër të artikujve të stoqeve. Konkurrentët më të afërt të kompanisë tashmë disa vite kanë zbatuar sistemin e shitjes online.

Kompania tash së voni është qortuar nga autoriteti rregullativ i standardeve të reklames lidhur me pretendimet e kompanisë se disa nga linjat e produkteve janë prodhuar nga 'druri ekologjik i qëndrueshëm'. Si rezultat i kësaj, dizajneri senior i produkteve është larguar nga kompania.

Bungu Shpk nuk ka ndonjë plan për të mbyllur ndonjërin nga dyqanet dhe shpenzimet e qirasë së dyqaneve përbëjnë njërin ndër kostot më të mëdha të kompanisë.

Dy nga huadhënësit kryesor (banka) të Bungu Shpk kanë shfaqur shqetësime lidhur me aftësinë e kompanisë për të përmbushur detyrimet e kredive dhe janë duke konsideruar tërheqjen e kredive. Drejtorët e kompanisë besojnë se kompania ka të ardhme të ndritur për shkak të profitabilitetit të mirë dhe për shkak të shifrave premtuese të shitjeve nga sistemi online. Auditorët e kompanisë janë informuar se drejtorët kanë caktuar takime me një numër të huadhënësve për të diskutuar mundësinë e ristrukturimit të kredive. Takimi është caktuar të ndodhë pasi që të përfundojë raporti i auditimit.

Kërkohe:

- a) Përshkruani përgjegjësitë e auditorit lidhur me hipotezën e vijimësisë. (2 pikë)
- b) Vlerësoni indikatorët e mundshëm që tregojnë se Bungu Shpk nuk operon sipas hipotezës së vijimësisë dhe vlerësoni ndikimin e mundshëm të tyre në aftësinë e kompanisë të vijojë operacionet. (8 pikë)
- a) Rekomandoni procedurat e auditimit që auditori i kompanisë duhet të kryejë në vlerësimin nëse kompania operon sipas hipotezës së vijimësisë. (6 pikë)
- b) Përshkruani ndikimin në raportin e auditimit nëse auditorët besojnë se ekziston një pasiguri materiale lidhur me statusin e vijimësisë së kompanisë. (4 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a)

Përgjegjësia e auditorit lidhur me hipotezën e vijimësisë është të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për përdorimin e hipotezës së vijimësisë nga menaxhmenti gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare.

Në mënyrë specifike auditori vlerëson vlerësimin e menaxhmentit për aftësinë e kompanisë të vazhdojë sipas hipotezës së vijimësisë dhe të arrijë në përfundim nëse ekziston ndonjë pasiguri material e cila mund të hedhë dyshim mbi aftësinë e kompanisë të vijojë operacionet e cilas duhet të shpaloset në pasqyrat financiare.

Nëse ngjarjet ose kushtet e identifikuar mund të hedhin dyshim mbi aftësinë e kompanisë të vijojë operacionet, auditori duhet të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të përcaktuar nëse ekziston pasiguria material përmes kryerjes së procedurave shtesë të auditimit, përfshirë ato në SNA 570 Hipoteza e Vijimësisë.

(2 marks)

(b)

Treguesit e hipotezës së vijimësisë

Treguesi	Pse mund të ndikojë në hipotezën e vijimësisë
Kompania është duke u ballafaquar me rënie të shitjeve në dy vitet e fundit.	Rënia e shitjeve do të thotë se kompania mund të ketë vështirësi në gjenerimin e rrjedhës së parasë për të mbuluar kostot.
Konkurrenca është rritur, e karakterizuar me 'çmime të zbritura' në mënyrë domethënëse.	Konsumatorët mund të ikin tek konkurrenca për shkak të çmimeve me zbritje ose kompania mund të zbres vetë çmimet deri në atë masë sa të mos jetë në gjendje të gjeneroj fitim ose rrjedhë të parasë së mjaftueshme.
Kompania ka investuar në një platform online për tregtinë elektronike.	Ekziston rreziku se platforma e re 'dështon' dhe kështu konsumatorët mund të kenë problem në blerje. Investimi mund të dështoj në mbulimin e kostove e që mund të rritë presionin financiar në kompani.
Investimet domethënëse janë financuar përmes kredive të reja nga banka.	Kosto të larta të financimit rrisin rrezikun që kompania të mos jetë në gjendje të gjenerojë para të mjaftueshme për të mbuluar koston e interesit. Ka rrezik se mund të shkelen kushtet e kredisë që mund të rezultojn me tërheqjen e kredisë në bankat.
Kompania është qortuar pas shkeljeve të standardeve të reklamimit.	Kjo mund të rezultojë me publicitet negativ dhe mungesë të besimit nga konsumatorët. Kjo pastaj mund të ndikojë në rënie të shitjeve por gjithashtu edhe në gjoba tjera që mund të ndikojë në hipotezën e vijimësisë.
Dizajneri senior është larguar nga kompania.	Humbja e personelit kyç do të thotë se kompania mund të mos jetë në gjendje të dizajnojë dhe prodhojë produkte që duan konsumatorët. Kjo mund të rezultojë në rënie të shitjeve dhe rrjedhës së parasë dhe të çojë në probleme me hipotezën e vijimësisë.

Shpenzimet e qirasë si kosto fikse, përbëjnë një pjesë domethënëse të shpenzimeve të kompanisë.	Rënia e shitjeve do të thotë se kompania mund ta ketë të vështirë të mbulojë kostot fikse. Është rrezik i madh që kompania mund të dështojë të paguaj borxhet me kohë.
Dy huadhënës janë duke konsideruar të tërheqin kreditë e tyre.	Kompania ka pak gjasa të vazhdojë tregtimin pa kredi. Huadhënësit mund të detyrojnë kompaninë në likuidim.

(c)

Procedurat e auditimit që auditori i kompanisë duhet t'i kryejë për të vlerësuar nëse kompania është e aftë të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë janë të listuara më poshtë:

- Përftoni dhe rishikoni parashikimet e rrjedhës së parasë dhe vlerësoni nëse është përfshirë ndikimi i rënies së shitjeve. Vlerësoni supozimet e bëra lidhur me shitjet e parashikuara nga sistemi online.
- Rishikoni pasqyrat menaxheriale pas fundit të vitit për dëshmi në rënie të performancës. Kjo mund të përfshijë ekzaminimin nëse kompania është në gjendje të mbulojë kostot e financimit.
- Rishikoni të dhënat për shitjet pas fundit të vitit lidhur me shitjet online për të përcaktuar nëse besimi i drejtorëve është i arsyeshëm.
- Diskutoni me menaxhmentin nëse kanë identifikuar ndonjë burim alternative të financimit në rast të tërheqjes së kredive nga bankat.
- Diskutoni me drejtorët cilat janë planet e tyre lidhur me zbritjet e çmimeve të ofruara nga konkurrenca.
- Ekzaminoni korrespondencat me avokatët dhe autoritetet rregullatore për të identifikuar nëse mund të ketë gjoba të mëtutjeshme kundrejt kompanisë.
- Rishikoni procesverbalet e taikimit të bordit për të identifikuar cilat janë planet e kompanisë lidhur me publicitetin negativ.
- Rishikoni korrespondencat me bankat për të përcaktuar nëse kompania ka shkelur ndonjë kusht nga bankat dhe që mund të ndikojë në vazhdimin e kredisë ose overdrafteve.
- Diskutoni me drejtorët cilat janë planet e tyre për publicitetin negativ nga shkelja e standardeve të reklamimit.
- Diskutoni me drejtorët nëse planifikojnë të zëvendësojnë dizajnerin e produkteve dhe vlerësoni se deri ku kanë shkuar planet për punësimin e personit të ardhshëm.

(d)

Pasiguria lidhur me përtëritjen dhe ristrukturimin e kredisë është një çështje e një rëndësie fundamentale, e cila duhet të sjellet në vëmendjen e aksionarëve.

Do të duhej të përfshihet një paragraf i theksimit të çështjes në raportin e auditimit. [ose paragrafi I emertuar 'pasigurite material lidhur me vijimesine]

Ky paragraf duhet të përfshihet pas paragrafit të opinionit dhe do të shpjegonte pasigurinë lidhur me hipotezën e vijimësisë dh do t'i referohej një shënimi në pasqyrat financiare ku janë paraqitur informatat e detajuara.

Opinionin e auditimit nuk do të ndryshonte, do të mbetet i pamodifikuar. Nëse megjithatë drejtorët do të dështonin të përfshinin një shënim në pasqyra financiare, auditori do të kualifikonte (rezervonte) opinionin me 'përveç për' për shkak të anomalisë materiale. Pasqyrat financiare do të përmbanin anomali për shkak të mos-shpalosjes së një pasigurie.

Detyra 3

Situatat në vijim kanë ndodhur në auditimin e katër kompanive të ndryshme për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019.

Violina ShPK

Në nëntor të vitit 2019, kompania është duke u ballafaquar me një padi të madhe gjyqësore me një grup të nënkontraktorëve të cilët e kishin paditur kompaninë për shkelje të kontratës. Padia është në vijim mirëpo ende nuk ka përfunduar. Para se të përfundoj padia nuk është e mundur të vlerësohet me ndonjë shkallë të besueshme detyrimi i kompanisë. Nuk është regjistruar ndonjë provizion e as nuk është bërë ndonjë shpalosje në pasqyrat financiare të kompanisë për ndonjë detyrim këtë vit. (5 pikë)

Klarineti ShPK

Stoqet prej €2.5 milion janë përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit, prej të cilave €275,000 kanë të bëjnë me punën në proces të një kontrate. Kontrata është menaxhuar nga një punonjës i kompanisë i cili u largua nga kompania dhe mori me vete të gjitha të dhënat për punën në proces. Kjo kontratë kishte një natyrë të specializuar dhe auditori nuk mund të gjejë ndonjë ekspert të përshtatshëm për ta vlerësuar atë. Prandaj nuk ishte në gjendje të verifikonte vlerën e kontratës në fund të vitit. Fitimi para tatimit i kompanisë Klarineti është €1.25 milion. (5 pikë)

Kitara ShPK

Në dhjetor 2019, kompania ka pranuar €1 milion grante qeveritare për të ndihmuar në blerjen e pajisjeve kapitale. Kitara Shpk ka kredituar 100% të granteve në pasqyrën e të ardhurave si 'të hyra tjera', edhe pse SNK 20 Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Shpalosja e Asistencës Qeveritare tregon qartë se grantet kapitale duhet të njihen në pasqyrën e të ardhurave me shumën e zhvlerësimit ndër vite. Kitara Shpk është kompani prodhuese dhe qarkullimi për vitin deri me 31 dhjetor 2019 është €50 milion, fitimi para tatimit është €10 milion. (5 pikë)

Piano ShPK

Në shkurt 2020, Piano Shpk, një prodhues lodrash është dashur të tërheq mallra nga tregu për shkak të një problemi që ka rezultuar me prodhim të lodrave të rrezikshme për festat e fundvitit. Është kuptuar se 25% të të gjitha stoqeve në fund të vitit ishin produkte me të meta. Drejtorët janë duke refuzuar të njohin ndonjë provizion për stoqet me të meta në pasqyrat financiare të fundvitit pasi që problemi është zbuluar pas fundit të vitit dhe tani më ato produkte janë tërhequr nga tregu dhe janë zëvendësuar me të tjera. (5 pikë)

Kërkohet:

- a) Sa i përket **katër** situatave të mësipërme, diskutoni nëse duhet të modifikohet raporti i auditimit, duke dhënë arsyet për përfundimin tuaj dhe duke përshkruar ndikimin në raportin e auditimit.

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

Violina

Ky shembull përfshinë pasiguri dhe po ashtu mosmarrëveshje me mungesë të shpalosjes në pasqyrat financiare lidhur me këtë pasiguri. Auditori do të duhej të rishikonte SNK37 për tu siguruar se nuk kërkohet ndonjë provision lidhur me pasigurinë për rezultatin e padisë gjyqësore. Auditori po ashtu duhet të rishikojë letrën nga avokati për të përfutur dëshmi lidhur me rezultatin e padisë para finalizimit të raportit të auditimit.

Nëse ka një detyrim kontingjent i cili nuk është shpalosur sipas kërkesës së auditorit, atëherë raporti i auditimit duhet të rezervohet si pasojë e mosmarrëveshjes. Nëse drejtorët përfshijnë shpalosje të mjaftueshme në shënimet e pasqyrave financiare, auditori (varësisht nga madhësia e padisë gjyqësore) mund të dojë të tërheq vëmendjen e lexuesve duke përdorur paragrafin e “theksimit të çështjes”.

Klarineti

Kjo duket të jetë kufizim i fushëveprimit pasi që është e paqartë nëse puna në proces është vlerësuar saktë në fund të vitit. Auditorët nuk ishin në gjendje të mbledhin dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme lidhur me këtë situatë. Është shumë materiale pasi që paraqet 22% të fitimit dhe 11% të llogarive të arkëtueshme. Në këtë rast auditori do të rezervojë opinionin për shkak se kufizimi në fushëveprim është material.

Kitara

Në këtë rast ka mosmarrëveshje, pasi që kompania nuk është në pajtueshmëri me standardet e kontabilitetit. Duhet të vlerësohet materialiteti i mosmarrëveshjes. €1 milion minus çfardo shume e cila do të ishte amortizuar për vitin mund të jetë materiale pasi që qarkullimi është €50 million prandaj 0.5-1% do të jetë €0.25 deri 0.5 milion. Korrigjimi nuk është saktësisht 10% i fitimit neto pasi që pasjisa nëse zhvlerësohet për 10 vite mosmarrëveshja do të ishte €0.9 milion. Mirëpo një masë e matjes së materialitetit është 2-5 % e fitimit neto prandaj në këtë rast do të jetë materiale. Nga rasti i mësipërm shihet se nevojitet të bëhet një rezervim i opinionit me “përveç për” ose të jepet një opinion i kundërt. Pasi që korrigjimi nuk është shumë i lart për ta kthyer fitimin në humbje dhe nuk konsiderohet anomaly përhapëse, atëherë opinion i kundërt do të ishte shumë ekstrem.

Piano

Në këtë rast e dijmë se 25% e stoqeve janë mbivlerësuar në fund të vitit dhe janë materiale pasi që një kompani e prodhimit të lodrave që shiten në festat e fundvitit do të mbante shuma materiale të stoqeve në fund të vitit. Nëse drejtorët refuzojnë të bëjnë korrigjimet e duhura në pasqyrat financiare për këtë çështje, atëherë auditori do të zgjedh në mes të opinionit me rezervë ose të kundërt. Nuk është e qartë ndikimi i kësaj mosmarrëveshje në pasqyrat financiare dhe nëse kjo është anomaly përhapëse që do të ndikonte në opinionin e kundërt.

Detyra 4

Është data 3 dhjetor 2020. Auditimi i REO SHA është gati në përfundim dhe pasqyrat financiare së bashku me raportin e auditimit do të nënshkruhen javën e ardhshme. Mirëpo, informatat shtesë për dy ngjarje materiale sapo i janë prezentuar auditorit. Viti fiskal i kompanisë është me 30 shtator 2020.

Ngjarja 1 – ka ndodhur me 10 tetor 2020

Materiali i dyerve të mobileve që prodhohen nga kompania janë me defekte dhe kështu përdorimi i këtyre dollapëve nuk është i sigurt për përdorim. Nuk ka pasur shitje të këtyre dollapëve; është planifikuar të dalin në treg pas disa javësh. Kompania e sigurimeve ka vlerësuar se vlera totale e stoqeve të prekura është €750,000. Po ashtu kompania e sigurimeve ka vlerësuar se vlera e këtyre stoqeve pas defekteve është vetëm €225,000. Nuk mund të bëhet kërkesë ndaj furnitorit të këtij materiali për kompenzim pasi që kompania është nën likuidim dhe nuk ka gjasa për kompenzim të palëve të treta. Gjithashtu kompania e sigurimit nuk mund të kompenzojë për këto defekte pasi që REO ka qenë e siguruar vetëm për vlera më të vogëla. Të gjitha këto stoqe kanë qenë në depon e mallrave të gatshme në fund të vitit dhe nuk është regjistruar ndonjë lëvizje e stoqeve në periudhën pas përfundimit të vitit.

Ngjarja 2 – ka ndodhur me 5 nëntor 2020

Prodhimi në njërin nga fabrikat e REO ishte ndalur për një ditë për shkak se kamioni i cili kishte bartur ngjyrën që përdoret për lyerjen e produkteve kishte rëshqitur nga rruga dhe kishte ndotur lumin e qytetit. Agjencia e Mjedisit tani është duke shqyrtuar nëse derdhja e ngjyrës në lumë është shkelje e ligjit të mjedisit. Kompania e sigurimit të REO ende nuk ka komentuar lidhur me këtë ngjarje.

Kërkohet

(a) Për secilën nga ngjarjet e mësipërme:

(i) Shpjegoni nëse ngjarja është ngjarje që kërkon korrigjim ose nuk kërkon korrigjim sipas *SNK 10 Ngjarjet pas periudhës së raportimit*. **(4 pikë)**

(ii) Shpjegoni përgjegjësinë e auditorit dhe procedurat e auditimit dhe veprimet që duhet të merren nga auditori në pajtueshmëri me *SNK 560 Ngjarjet pasuese*. **(12 pikë)**

(b) Supozoni se është data 20 dhjetor 2020, pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit sapo është nënshkruar, dhe takimi i përgjithshëm vjetor do të mbahet me 10 janar 2021. Agjencia e Mjedisit e ka lëshuar një raport në të cilin thuhet se REO ka shkelur ligjin mbi mjedisin dhe i ka vendosur një gjobë prej €900,000 e cila duhet të paguhet nga kompania. Kjo shumë është materiale për pasqyrat financiare.

Kërkohet:

Shpjegoni punën shtesë të auditimit që duhet të kryhet nga auditori sa i përket çështjes së gjobës. **(4 pikë)**

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja

(a) Ngjarja 1

(i) Problemi me stoqet e dyerve të dollapave ofron dëshmi shtesë për kushtet që kanë ekzistuar në fund të periudhës raportuese pasi që stoqet kanë ekzistuar dhe dyert janë përfshirë në stoqe në atë kohë.

Vlera e stoqeve është mbivlerësuar dhe duhet të zvogëlohet në vlerën cila do është më e ulëta, kosto ose vlera neto e realizueshme në pajtueshmëri me SNK 2 Stoqet.

Duhet të bëhet një korigjim në vlerën e stoqeve në pasqyrat financiare.

Prandaj stoqet e dyerve duhet të vlerësohen me vlerë prej €225,000 është që është vlera neto e realizueshme.

(ii) Zvogëlimi i vlerës së stoqeve ndodhi pas përfundimit të vitit por para se të nënshkruhen pasqyrat e auditimit dhe raporti i auditimit.

Prandaj auditori ende është përgjegjës për identifikimin e ngjarjeve materiale të cilat ndikojnë në pasqyrat financiare.

Procedurat e auditimit prandaj kërkojnë të përcaktojnë vlerën neto në libra të stoqeve dhe të kontrollojnë që €225,000 është vlera shitëse e mobileve.

Procedurat e auditimit do të përfshijnë:

- përftimi i dokumenteve nga kompania e sigurimit për të konfirmuar vlerësimin e tyre të vlerës së mobileve të dëmtuara.
- Kontakti i administratorëve të furnitorit të materialit të dyerve për të konfirmuar se nuk mund të japin kompenzime për materialin me defekt.
- Përftimi i pasqyrave financiare të ndryshuara dhe sigurimi se drejtorët kanë përfshirë €225,000 si vlerë në fund të periudhës së raportimit si dhe që vlera e stoqeve është zvogëluar me €225,000 në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e të ardhurave.
- Rishikimi i listave të stoqeve për tu siguruar se materialet me defekt nuk janë përdorur në mobilet tjera dhe se nuk kërkojnë korigjime të mëtutjeshme në stoqet tjera.
- Përftoni përfaqësime shtesë të shkruara për të konfirmuar saktësinë e vlerave të shlyera dhe për të konfirmuar se nuk ka artikuj tjerë të stoqeve që janë prekur.
- Në fund, vlerësimi i efektit në opinionin e auditimit pas vendimit të drejtorëve lidhur me vlerën e stoqeve. Mund të kërkojë një opinion me rezervë nëse nuk bëhen korigjime të duhura në pasqyra financiare.

Ngjarja 2

(i) derdhja e ngjyrës ka ndodhur pas përfundimit të periudhës raportuese, që do të thotë se këto tregojnë për kushtet që kanë ekzistuar PAS përfundimit të periudhës raportuese – ngjarja nuk mund të parashikohej në fund të periudhës raportuese.

Në këtë rast, nuk kërkojë korigjim i pasqyrave financiare.

Mirëpo, hetimi nga Agjencia e Mjedisit mund të rezultojë me kërkesa ligjore kundët kompanisë për ndotje joligjore të mjedisit, prandaj si ngjarje materiale kërkojë të shpalojë në pasqyrat financiare.

(ii) ngjashëm sikur me ngjarjen 1, ngjarja ndodhë para nënshkrimit të raportit të auditimit, prandaj auditorët kanë për detyrë të identifikojnë ngjarjet materiale që ndikojnë në pasqyrat financiare.

Procedurat e auditimit do të përfshijnë:

- Përftimi i dokumenteve për ngjarjen, psh procesverbalin e takimit të bordit, kopjet e legjislacionit mjedisor dhe mundësisht raportet e ndërmjetme nga Agjencia e Mjedisit për të përcaktuar shtrirjen e dëmit.
- Bisedat/pyetjet me drejtorët nëse ata do ta shpalojnë ngjarjen në pasqyrat financiare.
- Nëse drejtorët planifikojnë të shpalojnë ngjarjen, sigurohuni që shpalosja është e mjaftueshme.
- Nëse drejtorët nuk planifikojnë ta bëjnë shpalosjen, konsideroni nëse shpalosja është e nevojshme dhe informoni drejtorët.

- Nëse nuk është bërë shpalosja dhe auditorët konsiderojnë se shpalosja është e nevojshme, modifikoni opinionin e auditorit duke u bazuar në mosmarrëveshjen me menaxhmentin dhe shpjegoni arsyen për rezervimin e raportit. Kjo do të ishte për mungesën e shpalosjes edhe pse shuma e dëmit nuk mund të përcaktohet ende.
- në mënyrë alternative, nëse auditori konsideron se derdhja e ngjyrës dhe efekti i gjobës do të shkaktojë probleme të vijimësisë për kompaninë, atëherë duhet të përfshihet edhe një paragraf i theksimit të çështjes.

(b) Njoftimi për gjobën është pranuar pasi që raporti i auditimit është nënshkruar
Procedurat e auditimit do të përfshijnë:

- Diskutimi i çështje me drejtorët për të përcaktuar veprimet që do të ndërmerren.
- Në rast se drejtorët vendosin të korrigojnë shpalosjet e pasqyrave financiare, duhet të auditohen këto korrigjime dhe pastaj të riprodhohet raporti i auditimit me një datë të re.
- në rast se drejtorët vendosin të MOS korrigojnë shpalosjet e pasqyrave financiare, auditori duhet të konsiderojë metoda tjera të kontaktimit të aksionarëve. Për shembull, auditori mund të flasë para aksionarëve në takimin e përgjithshëm vjetor për t'i informuar ata për ngjarjen.
- Opsionet tjera siç është dorëheqja nuk duket e përshtatshme për shkak të datës shumë të afërt të takimit të përgjithshëm vjetor.

Dorëheqja do të lejonte që auditori të kërkojë nga drejtorët të therrasin takimin e përgjithshëm të jashtëzakonshëm, por kjo nuk mund të ndodhte para takimit të përgjithshëm vjetor, prandaj auditori duhet të flas para aksionarëve në këtë rast.

Detyra 5

Ju sapo keni përfunduar provimet për kontabilist të certifikuar dhe jeni ngarkuar si udhëheqës i departamentit të auditimit të brendshëm në kompaninë AB, një kompani që po rritet shumë shpejtë. Qarkullimi i kompanisë është rritur me 20% çdo vit në pesë vitet e fundit, dhe sot ky qarkullim është 50 milion euro. Fitimet neto po ashtu janë të larta, me një kthim të pranueshëm për të katër aksionarët.

Departamenti i auditimit është themeluar vitin e kaluar për të ndihmuar bordin e drejtorëve në kontrollin e tyre ndaj kompanisë dhe për tu përgatitur për regjistrim të mundshëm të kompanisë në bursë. Drejtori menaxhues është i gatshëm të ndjekë parimet e qeverisjes së mirë të korporatave sa i përket auditimit të brendshëm. Mirëpo, ai po ashtu është i vetëdijshëm se anëtarët tjerë të bordit nuk kanë njohuri të plotë për qeverisjen korporative ose njohuri të detajuar për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Kërkohet

Shkruani një memo për bordin e AB e cila:

- (a) Shpjegon se si departamenti i auditimit të brendshëm mund të ndihmojë bordin e drejtorëve në përmbushjen e obligimeve të tyre sipas parimeve të qeverisjes së mirë korporative. **(10 pikë)**
- (b) Shpjegon përparësitë dhe pengesat e komitetit të auditimit në kompani. **(10 pikë)**
- (Total = 20 pikë)**

Zgjidhja

(a) Fushat në të cilat departamenti i auditimit të brendshëm mund t'i ndihmojë drejtorëve në zbatimin e e qeverisjes së mirë korporative përfshijnë:

(i) **Kontrollet e brendshme**

Drejtorët janë përgjegjës për vlerësimin e rreziqeve me të cilat ballafaqohet organizata, implementimin e kontrolleve të duhura dhe monitorimin e efektivitetit të kontrolleve.

Departamenti i auditimit të brendshëm mund të ndihmojë bordin përmes një numri të mënyrave:

- Ata mund të rishikojnë vlerësimin e rrezikut dhe raportojnë mbi mjaftueshmërinë e atij vlerësimi
- Në disa fusha (ndoshta sa i përket sistemit të kontabilitetit) ata mund të bëjnë aktualisht vlerësimin e rrezikut
- Ata mund të rishikojnë dhe raportojnë mbi mjaftueshmërinë e kontrolleve që duhet të implementohen
- Ata mund të bëjnë auditime vjetore të efektivitetit të kontrolleve (duke kryer teste të kontrolleve), duke identifikuar dobësitë dhe duke rekomanduar përmirësimet

Nuk do të ishte e përshtatshme që ata të pëfshihen në secilën fazë, psh vlerësimi i rrezikut, dizajnimi i kontrolleve dhe rishikimi i efektivitetit pasi që kjo do të ishte se ata janë duke kontrolluar punën e tyre. Kjo do të rrezikonte kredibilitetin e raporteve të tyre.

Në disa aspekte, ekzistenca e auditimit të brendshëm shërben si procedurë e kontrollit. Shembull i kësaj mund të ishte se ekzistenca e departamentit të auditimit të brendshëm ka mundësi të veprorë si parandalues ndaj mashtrimit prandaj edhe i ndihmon drejtorët në përmbushjen e përgjegjësi të tyre për të zbatuar kontrolleve të duhura për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimin.

(ii) **Pasqyrat financiare**

Qeverisja e mirë korporative kërkon që drejtorëve të përgatisin pasqyrat financiare që japin një pamje të drejtë dhe të balancuar. Pasi që departamenti i auditimit të brendshëm ka përvorë në

kontabilitet dhe auditim dhe udhëhiqet nga një kontabilist i certifikuar ose auditor i certifikuar, ai mund të ndihmojë drejtorët në zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe përmbushjen e pritjeve të lexuesve të PF (pasi që pritet do të jenë më të mëdha sidomos nëse kompania vazhdon me regjistrimin në bursë).

(iii) Raportet e bordit

Një parim i mirë i qeverisjes së korporatës është se bordi duhet të informohet si duhet. Departamenti i auditimit të brendshëm mund të rishikojë raportet që i prezantohen bordit për të siguruar se ato janë përgatitur si duhet dhe se mund të kuptohen lehtë.

(iv) Komunikimi me auditorët e jashtëm

Edhe pse është komiteti i auditimit organi që kryesisht vepron si kanal i komunikimit në mes të auditorëve të jashtëm dhe bordit, shpesh mund të ndodhë që auditorët e jashtëm dhe auditorët e brendshëm do të punojnë së bashku në disa fusha. Kjo mund të ndodhë nëse auditorët e jashtëm mund të mbështeten në punën e auditorëve të brendshëm (psh në procedurat e numërimeve periodike të stoqeve) ose nëse auditorët e jashtëm duan të zgjerojnë testimin përmes kompjuterëve përgjatë tërë vitit nën mbikqyrjen e auditorëve të brendshëm. Kjo mund t'i shtojë vlerë informatave në dispozicion për bordin ku fushat janë konsideruar nga të dy grupet e auditorëve.

(v) Njohuria e qeverisjes së korporatës dhe standardeve të auditimit

Si profesionist të kualifikuar departamenti i auditimit të brendshëm ka njohuri të azhurnuara të kërkesave të qeverisjes së korporatës dhe zhvillimeve në standardet e auditimit. Ata mund të jenë në gjendje të ndihmojnë bordin të jetë i azhurnuar me kodet e qeverisjes së korporatës dhe me çështjet që priten nga auditorët e jashtëm.

(b) Avantazhet dhe disavantazhet e komitetit të auditimit

(i) Avantazhet

Regjistrimi i propozuar në bursë

Nëse AB regjistrohet në bursë sipas të gjitha gjasave ata duhet të ndjekin kërkesa më të detajuara siç është Kodi i KOMBnuar i qeverisjes së korporatës në Mbretërinë e Bashkuar. Themelimi i një komiteti të auditimit konsiderohet praktike e mirë e qeverisjes sipas këtij kodi. Nëse AB nuk e themelon komitetin, atëherëduhet të shpalesë mospajtueshmëri me kodin dhe kjo mund të ndikojnë në besimin e aksionarëve në raportimin financiar. .

'Mik kritik' i bordit

Komiteti efektiv i auditimit do të përbëhet nga individë me njohuri dhe përvojë relevante, të cilët janë të pavarur nga udhëheqja e përditshme e kompanisë. Kjo do të ju jep aksionarëve besim se ekziston një mbikqyrje e pavarur e bordit e cila do të ndihmojë të sigurihet se kompania udhëhiqet në interesin më të mirë të aksionarëve.

Komunikimi

Ekzistenca e komitetit të auditimit ofron një kanal komunikimi efektiv për auditorët e jashtëm. Kjo do të thotë se ekziston një organ pothuaj i pavarur me të cilin mund të diskutojnë auditorët e jashtëm çështjet e auditimit qofshin siç janë mospajtimet lidhur me trajtimet në kontabilitet e jot ë diskutohet direkt me bordin.

Raportimi financiar

Nga drejtorët joekzekutiv pritet të kenë njohuri të mirë të raportimit financiar. Në rastin e AB kjo do të provojë një burim të dobishëm të këshillave për bord. Po ashtu, së jashtëmi, kjo do të rritë besueshmërinë në proceset e raportimit financiar të AB.

Caktimi i auditorëve të jashtëm

Komiteti i auditimit, në vent të bordit, do të rekomandojë cilët auditorë do të caktohen. Ata po ashtu do të rishikojnë në bazë vjetore çfardo rrethana, siç janë ofrimin e shërbimeve tjera, të cilat

mund të kërcënojnë pavarësinë e auditorëve të jashtëm. Kjo përsëri do të rritë besueshmërinë e lexuesve të PF. ,

(ii) *Disavantazhet*

Kosto

Edhe pse drejtorët joekzekutiv nuk kërkojnë paga për orar të plotë, niveli i tarifave që kërkohet të tërheqin individ të përshtatshëm dhe me përvojë mund të jetë domethënës por duhet të krahasohet me përfitimet që do të dalin sidomos nga regjistrimi i planifikuar në bursë.

Njohuria dhe përvoja

Bordi do të interesohet nëse individët jashtë kompanisë AB kanë përvojën e mjaftueshme të biznesit për të kontribuar në mënyrë të dobishme në bord. Siç është shpjeguar më lart, është pavarësia e tyre e cila i shton vlerë rolit të tyre si dhe përvoja e tyre e caktuar lidhur me kontabilitetin financiar dhe çështjet e qeverisjes së korporatës.

Përgjegjësitë

Bordi aktual mund të jetë i brengosur se themelimi i komitetit të auditimit me drejtorë joekzekutiv mund të zvogëlojë fuqinë e tyre në udhëheqjen e kompanisë. Kjo mund të shihet si një shtresë tjetër e menaxhmentit. Ata duhet të sigurohen se komiteti i auditimit do të veprojë për të mbështetur bordin, e jo si alternativë e tij.